

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE**  
**HAXHIRAJ GROUP SH.P.K**

\*\*\*

Sot, më datë 18.11.2022 në Tiranë,

**Egli Haxhiraj**, i datëlindjes 29.11.1984, lindur ne Vlore, Shqiperi, madhor me zotesi te plotë juridike per të vepruar, i identifkuar me karte identiteti me nr. I41129062N.

I cili ka vodosur themelin e shoqërisë **HAXHIRAJ GROUP Shpk**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqeria **HAXHIRAJ GROUP Shpk** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vodos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqesimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.


**NENI 2**  
**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **HAXHIRAJ GROUP Shpk**

**NENI 3**  
**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

- Studio ligjore dhe fiskale , dhenia e konsulences dhe sherbimeve ligjore, financiare dhe fiskale.
- Ofrim i sherbimeve co-working per individe ose kompani per te shfrytezuar hapësirën e përbashkët të zyrave, Ofrim i sherbimit per te dhene me nenqira ambientet e zyres
- Shërbime ndërmjetësimi në shit-blerjen e pasurive te paluajtshme në Shqipëri dhe Itali
- Shërbime konsulence dhe ndërmjetësimi në projektet e investimeve strategjike të huaja dhe vendase në Shqipëri :Merger and Acquisition
- Blerjen , mbajtjen dhe administrimin e kuotave te kompanive te tjera te grupit



**NENI 4**  
**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Brigada VIII, Godina 8, Kati 2, Tirane.

**NENI 5**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është i ndarë në 1 kuote.

Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

**Z. Egli Haxhiraj** 1 kuotë, me vlerë 100 Lekë, zotëron 100%

**NENI 6**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

**NENI 7**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë: **Z. Egli Haxhiraj**, i datëlindjes 29.11.1984, lindur ne Vlore, Shqiperi, madhor me zotesi te plote juridike per të vepruar, i identifkuar me karte identiteti me nr. I41129062N.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:

a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit

b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.



## **NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

## **NENI 9**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## **NENI 10**

### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 11**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

## **NENI 12**

### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në dy kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjeten atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

## **ORTAKU THEMELUES**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Z. M. Ruzic".